



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
KRYETARI

PROJEKT -VENDIM

Nr.            Datë            . 03.2026

PËR

“ MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE SEZONALË NË SEKTORIN E UJITJES  
DHE KULLIMIT PËR PERIU DHËN PRILL, MAJ, QERSHOR TË VITIT 2026 “

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës", VKM Nr. 87, datë 6.2.2026 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialistëve të ndryshme në disa institucione të administratës publike, të ndryshuar", Ligjit Nr.35/2023 "Për kompetencat dhe caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", kërkesës për punonjës sezonalë drejtuar Drejtorisë së Ekonomisë Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse me nr. prot 1775 datë 12 .03.2026, me propozim të kryetarit të Bashkisë Kolonjë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 17 . 03. 2026.

PROPOZIJ:

- 1.Miratimin e shtimit të numrit të punonjësve sezonalë për sektorin e ujitjes dhe kullimit për periudhën tremujore, prill, maj, qershor 2026, i cili do të jetë 4 (katër).
- 2.Të paguhen me pagë 50 000 në muaj .
- 3.Fondi i pagës është planifikuar tek buxheti i vitit 2026.
- 4.Ngarkohet Drejtoria e Ekonomisë Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sektori i ujitjes dhe kullimit.
- 5.Ky projekt vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr 139/2015, datë 17.12.2015" Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETARI

Erion Isai



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË

RELACION  
PËR

PROJEKT-VENDIMIN  
Nr.        Datë        . 03.2026

Nr. 1742/Prof

Data: 12.03.2026

**“PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE SEZONALË NË SEKTORIN E  
UJITJES DHE KULLIMIT PËR PERIUdhËN PRILL, MAJ, QERSHOR TË VITIT  
2026 “**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës", VKM Nr. 87, datë 6.2.2026 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialistëve të ndryshme në disa institucione të administratës publike, të ndryshuar", Ligjit Nr.35/2023 "Për kompetencat dhe caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", kërkesës për punonjës sezonalë drejtuar Drejtorisë së Ekonomisë financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse me nr. prot 1775 datë 12.03.2026, me propozim të kryetarit të Bashkisë Kolonjë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 17.03.2026.

Kërkojmë të mbështetemi me punonjës sezonalë, për shkak të sipërfaqes së madhe të territorit dhe gjatësisë së kanaleve ujitëse dhe kullues. Situata e rreshjeve të muajit nëntor – dhjetor 2025 dhe janar 2026 sollën problem në mbushje dhe shkarje të argjinaturave të kanaleve ujitëse.

Skema ujitëse për të cilin kërkohen fuqi punëtore janë :

Skema ujitëse Kozel, Barmash, Kanjinas, Kabash- Ersekë, Gostivisht, Borovë, Rehovë, Psar Starje.

Në buxhetin e planifikuar për vitin 2026 është parashikuar fondi për punonjës sezonalë.

Shtimi i numri të punonjësve sezonalë për periudhën, prill, maj, qershor 2026 , është **4 (katër)**.


Këta punonjës do të paguhen me pagën minimale , bruto 50,000 lek

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij projekt vendimi për periudhën tremujore (prill, maj, qershor) të vitit 2026, përballohen nga buxheti i institucionit të bashkisë Kolonjë, miratuar me VKB Nr .154 , datë 12.12.2025.

Konceptoi: E.Gora, 

L.Veizi 

Pranoi : G.Eminaj 

Miratoi : D.Tallo 

Konfirmoi: N/kryetar Petro Risto 

